



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2022

Prishtinë, maj 2023

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjilanit (KGJ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Komuna kishte paguar për inventar zyrtar tavolina pune dhe ormana të cilët nuk gjenden në komunë. Vlera e këtij inventari sipas ekzaminimit tonë fizik është 83,493€.
- A2 Pasuria jo kapitale me vlerë nën 1,000€, e prezantuar (2,040,228), në nenin 19.3.2 në Raportin Vjetor Financiar nuk është e plotë dhe e saktë pasi që komuna nuk e kishte regjistruar pasurin jokatitale në regjistrat kontabël të pasurive.
- B1 Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria ekonomike investime kapitale kishte pagur për kategorinë që për nga natyra klasifikohen mallra dhe shërbime në vlerë 605,692€.
- B2 Pasurit kapitale mbi 1,000€ të prezantuar (230,506,091) në nenin 19.3.1 të Raportit Vjetor Financiar (RVF) ishin nënvlerësuar për 231,535€.
- A3 Pagesa e faturës në vlerë 5,480€, për shërbime zërimi pa procedura kontraktuale.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjilanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A4 Për realizimin e projektit “Studimi i fizibilitetit për zonën ekonomike dhe projekti ideor për dizajnimin e qendrës së qytetit” komuna nuk e kishte zbatuar ligjin e prokurimit publik.
- B3 Komuna për projektet "Pastrimi i objekteve shkollore" në vlerë 127,640€, kishte aplikuar procedurën jo adekuate të prokurimit.
- B4 Kontratat “Sanimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik në fshatrat e Komunës së Gjilanit” dhe “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit” ishin tejkaluar për 80,575€.
- A5 Komuna në vitin 2022, menaxhimin e kontratave nuk e kishte përgatitur dhe mbajtur përmes sistemit elektronik të prokurimit.
- B5 Komuna kishte angazhuar të punësuar me kontratë për shërbime të veçanta pa i respektuar procedurat e prokurimit publik.
- B6 Për pagesat në vlerë prej 607,550€, nuk ishin respektuar hapat për procedim të pagesave.
- B7 Komuna nuk kishte arritur ta bëjë inspektimin (verifikimin) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.
- A6 Për vitin 2022 nuk ishte hartuar plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjilanit.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Gjilanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjilanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjilanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjilanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: moszbatim i procedurave të duhura të prokurimit, tejkalim i kontratave, menaxhim jo të mirë me kontratat, mungesë fizike të pasurive, mungesë e planit për mbështetje financiare për subvencione, dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dobësi në regjistrimin e pasurisë jo financiare, përfshirë edhe kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korigjimet e mundshme. Megjithatë çështjet që ndërlidhen me pasuritë, keqklasifikimin e shpenzimeve janë paraqitur jo saktë dhe drejtë në PFV. Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre 6 janë rekomandime të reja, 9 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Mungesa e inventarit zyrtarë tavolina pune dhe ormana

##### Gjetja

Neni 23 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF - Shpenzimi i Parave Publike parasheh se “Pranimi i mallit/ shërbimit bëhet nga zyrtari/komisioni i autorizuar. Raporti i pranimit mallit /shërbimit nga zyrtari/ komisioni i autorizuar duhet t'i dorëzohet Zyrës për buxhet dhe Financa. Zyrtari / komisioni i autorizuar për pranimin e mallrave/shërbimeve të zbatoj dispozitat e parapara me rregullat për menaxhimin e pasurisë qeveritare”. Po ashtu pika 61.20.a e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh se një ndër funksionet e menaxherit të projektit është edhe “Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës”.

Komuna e Gjilanit respektivisht Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) gjatë vitit 2022, ishte furnizuar me inventar zyrtarë tavolina pune dhe ormana nga Lot 1 i kontratës së lidhur me datën 10.06.2021, nga Autoriteti Qendror i Prokurimit me numër prokurimi AQP 20-0005-111. Gjatë vitit furnizimet dhe pagesat ishin bërë pesë herë në vlerë totale prej 91,593. Furnizimi i pari ishte me 24.05.2022, në vlerë 12,800€, furnizimi i dytë me 31.05.2022, në vlerë 8,000€, i treti me 12.07.2022, në vlerë 14,783€, i katërti me 19.08.2022, në vlerë 41,235€ dhe furnizimi i pestë me 16.09.2022, në vlerë 14,775€. Kemi vërejtur se ky proces ishte përcjellë me mangësi si:

- Komisioni prej tre anëtarësh për pranimin e inventarit ishte emëruar

me vonesë (05.09.2022), nga drejtoresha e QKMF-së, pra pasi që ishin bërë katër furnizime.

- Fletëdergesat e mallit ishin pranuar dhe nënshkruar nga zyrtarët e ndryshëm;
- Faturat ishin nënshkruar nga tre zyrtarët që ishin emëruar si komision për pranimin e inventarit. Komisioni i pranimit të inventarit deklarohet se me kërkesë të menaxhmentit janë nënshkruar në faturë vetëm për tu ekzekutuar pagesa dhe se nuk kanë njohuri në lidhje me inventarin.
- Menaxheri i projektit në raportet e menaxhimit të kontratës të cilat i ka dërguar në zyrën e prokurimit cek se mallrat janë pranuar konform fletëdërgesës dhe faturës të nënshkruar për pranim nga komisioni.

Më tutje, ne nga lista e këtyre furnizimeve, kemi përzgjedhur 12 artikuj për të verifikuar ekzistencën e tyre fizike në QKMF. Me ne gjatë ekzaminimit fizik ishte drejtoresha e QKMF-së dhe komisioni për regjistrimin e inventarit në QKMF.

Gjatë ekzaminimit fizik ne nuk e gjetëm inventarin i cili ishte paguar. Pas konstatimit të kësaj gjendje kemi kërkuar nga akterët që të na informojnë lidhur me mungesën e inventarit, mirëpo asnjëri nga ta (drejtoresha e QKMF-së, komisioni për pranimin e inventarit dhe menaxheri i projekti) nuk ofruan ndonjë informatë se ku gjendet ky inventar.

Vlen të theksohet se ky inventar nuk ishte i regjistruar në regjistrin e pasurive nën 1,000€.

Lista e inventarit të ekzaminuar fizikisht i cili ishte paguar sipas paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar dhe i cili nuk ekzistonte në QKMF është i listuar më poshtë.

Inventari i cili mungon në QKMF				
Nr. Rendor	Përshkrimi i inventarit sipas kontratës	Totali i sasisë së pranuar	Çmimi	Totali i paguar në euro
1	1.1 Tavoline pune – e cila duhet të jetë e punuar nga MDF me trashësi 42 mm me metodë speciale. Struktura e këmbëve duhet të jetë nga metali 40x20 mm me profile të formuara si kuti 15x15 mm me strumbulla të veçanta të aluminit. Këmbët të lyera me elektrostاتيke me pluhur, duhet të ketë dy-tri fioka me sistem të hapjes në shtytje, dhe të ketë sistemin e kalimit të kabllave elektrike. Dimensionet 260x90x75cm.	96	200	19,200
2	2.1 Tavoline pune e punuar nga melanine me trashësi 36 mm, të ketë një pjesë përmbi të punuar me MDF me trashësi 18mm, pllaka e përparme e kombinuar e dy paneleve me trashësi 18mm dhe 30mm. Të ketë kanal plastik për kalimin e kabllave. Dimensionet – 260x90x75 cm.	53	100	5,300
	2.2 Anësore për tavoline e cila duhet të jetë e të njëjtit model, material sikur se tavolina, duhet të ketë një sirtarë me tri fioka me sistemin e hapjet me shtytje. Dimensionet – 140x55x61 cm.	16	100	1,600
3	3.1 Tavoline pune e punuar nga MDF me trashësi 18 mm, duhet të ketë një pjesë të lyer me llak për vendosje të lapsave, me këmbë metalike. Të ketë kanal plastik për kalimin e kabllave. Dimensionet – 220x100x74 cm.	99	400	39,600
	3.2 Anësore për tavoline e cila duhet të jetë e të njëjtit model, material sikur se tavolina, duhet të ketë dy sirtarë të punuar nga MDF i llakuar me sistemin e hapjes me shtytje. Dimensionet – 130x55x61 cm.			



7	Tavoline pune duhet të jetë e punuar nga MDF 18 mm, dhe skajet e tavolinës të jenë të zbukuruara dhe të lakuara, duhet të ketë edhe hapjen për kalim të kablllove. Këmbët e punuara nga druri i ngurte duke u fiksuar në profilin e aluminit të ndërlidhura njëra me tjetrën. Profili i aluminit të jetë i ngjyrosur me boje elektrostatische me pluhur. Të ketë edhe rregullimin e lartësisë së këmbeve. <b>Dimensioni - 160x80x74 cm.</b>	46	100	4,600
8	Tavoline për takime e punuar nga MDF i laminiuar dhe I ljer me llak, pjesa e elektrifikimit duhet të vij nga mesi dhe të lidhet me pjesën e sipërme, këmbët dhe mbajtëset e tavolinës duhet të jenë të punuara në mënyrë special nga alumini, pjesa e sipërme duhet të jetë e fiksuar me profilet. <b>Tavolina gjysmë rrethore ose drejtkëndeshe 9.1 480x160x73</b>	21	40	840
	<b>9.2 440x160x73</b>	4	42	168
10	Tavoline për takime për 4 persona - 120x120x74 e cila duhet të punohet nga kompakt melamine 18mm. Struktura/këmbët duhet të jenë të punuara nga alumini i injektuar të cilat janë të lidhura me profile, dhe duhet të jenë të ljera me pluhur elektrostatik, këmbët duhet të ketë mundësinë e ndërrimit të lartësisë.	23	20	460
11	Komodë e cila duhet të jetë e punuar nga melamine ku pjesa e sipërme dhe ndarjet duhet të jenë 30mm, duhet të ketë dy ndarje horizontale dhe vertikale, të ketë mekanizmin e mbylljes pa zhurme, xhamat të jetë të zalluar me profil të aluminit rrëshqitës. <b>Dimensionet - 200x50x120cm.</b>	71	50	3,550
12	Komodë e cila duhet të jetë e punuar nga melamine ku pjesa e sipërme dhe ndarjet duhet të jenë 30mm, ndërsa dyer 18mm rrëshqitëse, duhet të ketë dy ndarje horizontale dhe vertikale, të ketë mekanizmin e mbylljes pa zhurme. <b>Dimensionet - 200x50x120cm.</b>	55	35	1,925
14	Orman me dyer xhami i cili duhet të jetë e punuar nga melamine me ku pjesa e sipërme duhet të jetë 30mm, ndërsa dyert me xham të zalluar të rrethuar me alumini, duhet të ketë pesë ndarje horizontale. <b>Dimensionet - 80x42x190 cm.</b>	125	50	6,250
totali		662		83,493

Kjo ka ndodhur si rezultat i dështimeve të kontroleve me rastin e furnizimit dhe pranimit me inventarë.

#### Ndikimi

Pagesat e bëra për inventarin zyrtarë i cili nuk gjendet në komunë ndikon në dëmtimin e buxhetit komunal.

#### Rekomandimi A1

Kryetari duhet të kërkojë llogaridhënie nga zyrtarët përgjegjës në pajtim me kërkesat ligjore dhe të ndërmerr masa të menjëhershme për tu siguruar se inventari i paguar sa më shpejt do të vendoset në QKMF.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A2 - Mos përdorimi i programit të e-pasurisë dhe mungesë e regjistrave për pasurinë nën 1,000€

##### Gjetja

Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Nga testimi jonë ka rezultuar se pasuria jo kapitale nën 1,000€, për vitin 2022, nuk ishte regjistruar në sistemin e-pasurisë apo në ndonjë regjistrë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu Komuna në mungesë të regjistrit nuk i ka shpalosur këto pasuri në aneksin e RVF-së. Prandaj si rezultat i mungesës së regjistrave kontabël, ne nuk ishim në gjendje të vlerësojmë plotësinë dhe saktësinë e pasurisë

nën 1,000€, të prezantuar (2,040,228), në nenin 19.3.2 në Raportin Vjetor Financiar.

Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës së zyrtarëve që merren me menaxhimin e pasurive nën 1,000€ dhe kontrolleve të dobëta që kishte menaxhmenti i komunës ndaj këtyre zyrtarëve.

- Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurisë nën 1,000€, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, ndikon humbjen a po tjetërsimin e pasurisë dhe prezantimin e informatave jo të plota në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi A2** Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive do ta regjistrojnë pasurinë nën 1,000€, në regjistrat kontabël të pasurive.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve

- Gjetja** Udhëzim Administrativ MF-nr.04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale parasheh se "Data kur asetit është për herë të parë i gatshëm për përdorim dhe në gjendje të përdoret siç është menduar është data e komisionimit (pranimi teknik) të asetit. Nga kjo datë, shpenzimet e operimit, riparimit dhe mirëmbajtjes konsiderohen si shpenzime rrjedhëse" Po ashtu, neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të kenë në kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë".

Komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve ku nga kategoria ekonomike investime kapitale kishte paguar 605,692€, për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve. Shpenzimet e paguara kanë të bëjnë me mirëmbajtjen teknike të objekteve komunale, sanimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publikë si dhe mirëmbajtjen verore të rrugëve ekzistuese. Të njëjtat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive mbi 1,000€, sepse zyrtari i pasurive ka vlerësuar se këto shpenzime nuk e plotësojnë kushtin për të qenë pasuri kapitale.

Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.

- Ndikimi** Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpesh në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B2 - Nënvlërësimi i pasurive mbi 1,000€**

**Gjetja** Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1. përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël, si dhe Neni 6.3. përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria.

Pasurit kapitale mbi 1,000€ të prezantuara në nenin 19.3.2 në Raportin Vjetor Financiar ishin nënvlërësuar për shkak se pagesat në vlerë prej 231,535€, nuk ishin regjistruar në SIMFK.

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë të zyrtarit të pasurive për t'i regjistruar të gjitha pasurit në sistemin e pasurive kapitale.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i drejtë i pasurisë sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, ndikon në prezentimin e informatave jo të sakta në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontroleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A3 - Pagesa e faturës për shërbime zërimi pa procedura kontraktuale**

**Gjetja** Neni 26 paragrafi 2 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF - Shpenzimi i Parave publike parasheh se për procedim të pagesës kërkohen këto dokumente "Kërkesa për blerje / zotimi, kopja e kontratës që është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit si kopje autentike e origjinalit, urdhër blerja, raporti i pranimit, urdhër pagesa, fatura origjinale.

Pagesa e faturës në vlerë prej 5,480€, ishte bërë për shërbimet e zërimit në llogarinë e operatorit ekonomik nga kodi ekonomik shërbime teknike me vendim të Kryetarit të Komunës. Për pagesën e bërë nuk kemi gjetur kontratë të nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe raport të pranimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të vendimit të Kryetarit për të bërë pagesën e shërbimeve të zërimit të cilat ishin mbajtur në kuadër të flakës së janarit.

**Ndikimi** Pagesa e bërë vetëm përmes vendimit të Kryetarit pa dokumentet përcjellëse të kërkuara, ndikon në shmangien e kërkesave të parapara ligjore.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se janë respektuar kërkesat ligjore lidhur me furnizimet/shërbimet, në mënyrë që edhe vendimet të jenë të bazuara mbi

plotësimin e kushteve pasi të jenë kompletuar dokumentacioni i paraparë për pagesë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A4 - Lidhja e marrëveshjes pa zbatuar Ligjin dhe Procedurat e Prokurimit Publik

**Gjetja** Nenit 73 paragrafi 2 i LPP parasheh se “Konkursi i projektimit do të ushtrohet në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtat afate kohore siç ushtrohen aktivitetet e prokurimit për kontratat me vlerë të madhe që zbatojnë procedurat e hapura ose të kufizuara. Po ashtu neni 7 paragrafi 2 i LPP parasheh “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”.

Kryetari i Komunës me datë 08.04.2022, kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi me kolegjin UBT për realizimin e projekteve " Studimi i fizibilitetit për zonën ekonomike dhe projekti ideor për dizajnimin e qendrës së qytetit". Kosto totale e projektit " Studimi i fizibilitetit për zonën ekonomike ishte 20,000€, ku nga kjo vlerë UBT do ta mbulonte me 6,000€, ndërsa komuna me 14,000€, kurse kosto totale e "Projektit ideor për dizajnimin e qendrës së qytetit" ishte 4,200€ i mbuluar nga komuna. I gjithë ky proces ishte bërë pa zbatuar ligjin dhe procedurat e prokurimit publik.

**Ndikimi** Lidhja e marrëveshjes për marrjen e shërbimeve nga operatori ekonomik pa zbatuar ligjin e prokurimit publik ndikon në dëmtimin e konkurrencës dhe diskriminimin e operatorëve tjerë ekonomik.

**Rekomandimi A4** Kryetari me rastin e marrjes së shërbimeve nga operatorët ekonomik duhet të zbatoj ligjin dhe procedurat e prokurimit publik për tu siguruar se nuk është duke u reduktuar apo eliminuar konkurrenca në mes operatorëve ekonomik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Përdorimi i gabuar i procedurës së prokurimit****Gjetja**

Pika 52 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh “Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë është procedurë që e përfshinë Autoritetin Kontraktues (AK) që, pa publikim, të negocioj termat e kontratës drejtpërdrejt me një apo më shumë Operator ekonomik. Kjo është një shmangie prej parimeve themelore të çiltërsisë, transparencës, dhe konkurrencës si dhe është procedurë shumë e jashtëzakonshme. Kjo procedura për kontratat punë ose shërbime sipas rregullës përdoret në rastin: për shërbime; nëse pason prej konkursit për projektim; nëse një AK gëzon të drejta ekskluzive për të ofruar shërbime të tilla.

Për punë ose shërbime shtesë që nuk janë përfshirë në kontratën origjinale që u nënshtrohen disa kushteve të caktuara (OE i njëjtë ekzekuton shërbimet ose punët shtesë, që nuk mund të ndahen në mënyrë teknike ose ekonomike, megjithëse si të ndara janë tejet të nevojshme për kompletim, si dhe vlera nuk është më shumë se 10% e vlerës së kontratës origjinale); dhe

Për shërbime ose punë të reja që përbehen nga përsëritja e punëve ose shërbimeve të ngjashme që i janë besuar OE që i nënshtrohet disa kushteve të caktuara (janë në përputhje me projektin bazë, kjo mundësi është e zbuluar në tender, ndodh brenda 2 viteve pas përfundimit të kontratës fillestare si dhe vlera nuk është më shumë se 10% të vlerës së kontratës origjinale)”.

Zyra e prokurimit kishte lidhur dy kontrata për pastrimin e objekteve shkollore, njëra me 13.04.2022, në vlerë 40,262.86€, për një muaj dhe tjetrën me 18.05.2022, në vlerë prej 87,377.37€, deri në zgjidhjen çështjes së pastrimit të objekteve, duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Zyra e prokurimit në këtë rast është dashhtë ta përdorë procedurën e hapur për shkak se asnjë nga kriteret e përmendura nga rregulla dhe udhëzuesi operativ nuk janë plotësuar për ta përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit.

Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e zyrës së prokurimit për t’i respektuar kërkesat e parapara ligjore.

**Ndikimi**

Aplikimi i procedurës jo adekuate mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës, transparencës lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit.

**Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurojë zyra e prokurimit aplikon procedurat e duhura të prokurimit ashtu siç parashihet me kërkesat ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Tejkalim i kontratave****Gjetja**

Neni 56.15 Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit" artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi". Po ashtu neni 25 paragrafi 1.2 i Rregullës financiare nr. 01/2013 MF shpenzimi i parave publike parasheh "Çertifikuesi të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave".

Komuna me datën 08.11.2019, kishte lidhur kontratë publike kornizë me çmim për njësi për "Sanimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik në fshatrat e Komunës së Gjilanit" në vlerë 250,000€. Sipas raportit të menaxherit të kontratës punë të kryera me këtë kontratë janë 312,575€, të cilat edhe ishin paguar. Pra totali i tejkaluar i kontratës është 62,575€.

Po ashtu kontrata e lidhur me 26.04.2021, në vlerë prej 60,000€, për "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit" ishte tejkaluar për 18,000€. Për këtë tejkalim nuk ka ndonjë arsyetim nga menaxheri i kontratës.

Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të mirë të kontratës si dhe certifikimit të pagesës jo në pajtim me kërkesat ligjore.

**Ndikimi**

Tejkalimi i kontratave ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paarsyeshme dhe të paplanifikuara të parasë publike si dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.

**Rekomandimi B4**

Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave dhe pagesat mos të bëhet nga çertifikuesi pa u siguruar se kontrata po zbatohet në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A5 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit****Gjetja**

Pika 61. Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës së kontraktuesve paragrafi 20.f. i Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh "Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".

Komuna e Gjilanit menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve nuk e ka mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencave të menaxherëve të projekteve.

**Ndikimi** Mosmbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B5 - Mangësi lidhur me marrëveshjet për shërbime të veçanta**

**Gjetja** Neni 84 i Ligjit për Zyrarët Publik Nr. 06/L-114, përcakton se, "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik".

Komuna në RVF për vitin 2022 kishte raportuar 29 persona me marrëveshje për shërbime të veçanta. Ndonëse ka zvogëlim të numrit të tyre nga viti i kaluar (103), megjithatë, në pesë (5) mostra të testuara, kemi identifikuar se komuna nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit publik për angazhimin e tyre. Kontratat e nënshkruara mes kryetarit dhe të angazhuarve ishin për pozitat: zyrtare në zyrën për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc, inspektor i shërbimeve publike, inxhinier i komunikacionit, zyrtar për protokoll dhe asistente administrative.

Kjo ka ndodhur si pasojë e veprimeve jo adekuate të marra nga Kryetari, duke iu shmangur kërkesave të parapara me ligjin e zyrtarëve publik.

**Ndikimi** Moszbatimi i kritereve të përcaktuara ligjore për angazhimin e personave me marrëveshje për shërbime të veçanta cenon parimin e konkurrencës, transparencës si dhe ndikon në diskriminimin e të tjerëve.

**Rekomandimi B5** Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B6 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare**

**Gjetja** Neni 22 i Rregullës Financiare NR.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet Urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 43 mostrat të testuara si pjesë e testeve substanciale në kategorinë



e Mallrave dhe Shërbimeve, kemi vërejt se në 15 raste në vlerë 607,550€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është sjellë situacioni për punët/ mallin dhe shërbimet e pranuar dhe fatura e pastaj është lëshuar Urdhërblerja.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e prokurimit me rastin e procedimit të urdhërblerjes.

#### **Ndikimi**

Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

#### **Rekomandimi B6**

Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit do të ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B7 - Mosverifikimi i plotë i pronave komunale**

##### **Gjetja**

Nenit 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Komuna e Gjilanit kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për 38,142 objekte. Komuna në vitin 2022 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 4132 objekteve apo rreth 10.8%.

Mos verifikimi i pronave kishte ndodhur për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm.

##### **Ndikimi**

Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

##### **Rekomandimi B7**

Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A6 - Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ**

##### **Gjetja**

Rregullorja MF- nr.-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve parash se "Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës".

Komuna nuk kishte përgatit planin vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve për vitin 2022.

Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti kishte dështuar ta hartoj planin vjetor për mbështetje të OJQ-ve ashtu siç parashihet me kërkesa ligjore.

- Ndikimi** Mungesa e planit për mbështetje financiare i pamundëson komunës që të ketë informata të qarta në lidhje me fushat që planifikohen të mbështeten.
- Rekomandimi A6** Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprimet për hartimin e planit vjetor për mbështetjen e OJQ-ve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2022 ka shpалosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 13,667,617€. Krahasuar me vitin e kaluar (12,672,851€), ato janë rritur për 994,766€.

#### Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të arkëtueshmeve (LIA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Për mostrat tona nuk kemi vërejt që komuna ka marr ndonjë veprim konkret për vitin 2022 për inkasimin e LIA. Pjesëmarrjen më të madhe të të akretueshmeve e ka tatimi në pronë me 11,577,131€, pastaj licencat e biznesit 1,745,450€, qiratë 306,425€, dhe të tjerat me 38,611€.

Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

**Ndikimi** Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

**Rekomandimi B8** Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.2 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2022, ishte 4,599,011€. Krahasuar me vitin paraprak (11,034,955€) ato janë zvogëluar për 6,435,944€. Në pagimin (zvogëlimin) e obligimeve përveç tjerash ka ndikuar edhe vendimi i qeverisë për ndarje të mjeteve në vlerë prej 3,000,000€, për t'i paguar obligimet ndaj shpronësimeve.

#### Çështja B9 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara

##### Gjetja

Vendimet përfundimtare të nënshkuara nga Kryetari i Komunës për shpronësimin e pronave parashohin që "Nga dita e hyrjes në fuqi e vendimit obligohet Organi Shpronësues (Komuna) që brenda afatit prej 24 muaj të paguaj plotësisht shumën e kompenzimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, Departamenti i Tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave".

Po ashtu neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Ne kemi vërejtur se Komuna obligimet e papaguar nuk i kishte paguar brenda afatit të paraparë prej 24 muajve sipas vendimeve përfundimtare dhe 30 ditë me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike. Vonesat janë vërejtur në një rast tek shpronësimet ku vlera e obligimit ishte 296,443€, dhe në 16 raste vonesat në pagesë në vlerë 397,247€, ishin për kategoritë mallra dhe shërbime dhe investime kapitale.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ka vendos të bëjë shpronësime duke nxjerr vendime përfundimtare për shpronësime pa pasur mjete dhe pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

##### Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

##### Rekomandimi B9

Kryetari duhet të sigurojë shlyerjen e obligimeve të papaguara brenda afatit të paraparë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>29,075,278</b>	<b>33,452,659</b>	<b>32,109,663</b>	<b>28,862,333</b>	<b>27,361,357</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	24,605,224	26,822,547	26,458,539	23,632,751	23,241,424
Financimi përmes huamarrjes	0	195,247	195,247	90,910	239,711
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,744,453	1,650,040	695,640	741,694
Të hyrat vetanake	4,470,054	4,470,054	3,710,468	3,866,687	2,608,996
Donacionet vendore	0	59,502	46,462	7,569	22,237
Donacionet e jashtme	0	160,856	48,908	568,776	507,294

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,377,381€. Kjo rritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, financimit nga huamarrja si dhe donacioneve.

Komuna ka shpenzuar rreth 96% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>29,075,278</b>	<b>33,452,659</b>	<b>32,109,663</b>	<b>28,862,333</b>	<b>27,361,357</b>
Pagat dhe mëditjet	16,199,142	15,615,853	15,186,827	15,958,854	15,816,156
Mallrat dhe shërbimet	4,727,834	5,311,630	5,032,485	4,186,070	4,189,744
Komunalitë	576,800	612,728	568,787	588,601	456,408
Subvencionet dhe transferet	970,000	1,404,346	1,165,387	803,898	1,159,159
Investimet Kapitale	5,841,502	10,508,102	10,156,178	7,324,911	5,739,889
Rezervat	760,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 583,289€, krahasuar me buxhetin fillestar për shkak se komuna nuk kishte arritur ta bëjë rekrutimin e stafit ashtu siç ishte planifikuar.

Fillimisht ky zvogëlim vjen nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës ku ishin marr mjete në vlerë 812,677€, rritje nga donacionet 14,596€, rritje nga huamarrja me vendim të qeverisë 195,246€ dhe rritje nga të hyrat vetjake 19,546€.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 583,796€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2021, 553,763€, si dhe rritje nga donacionet për 30,033€.

Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 35,928€, nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2021.


Buxheti final për subvencione ishte rritur për 434,346€, nga kjo vlerë: 237,321€, rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2021, 30,000€, rritje me vendim të qeverisë, dhe 167,025€, rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,666,600€.

Kjo rritje vjen si rezultat i ndarjes së mjeteve me vendim të qeverisë në vlerë 3,000,000€, për pagesën e obligimeve të shpronësimit, 366,000€, me vendim të Kuvendit Komunal nga rezervat janë bartur tek kapitale, të hyrat vetjake të pashpenzuara nga viti 2021, 897,894€, rritje 394,000€, me vendim të Kuvendit Komunal nga rezervat në fondin 21, si dhe rritja prej 8,705€, nga grandet e donatorëve.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2022, për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 205,604€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2022 ishin 4,470,054€, përderisa ishin realizuar 4,245,470€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 915,570€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 20,600€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>4,470,054</b>	<b>4,470,054</b>	<b>4,245,470</b>	<b>4,837,641</b>	<b>2,758,090</b>
Të hyrat tatimore	2,643,737	2,643,737	2,484,945	2,312,933	1,340,924
Të hyrat jo tatimore	1,826,317	1,826,317	1,740,129	2,505,694	1,417,166
Të hyrat tjera	0	0	20,397	19,014	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021, ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2021 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, pesë (5) rekomandime janë zbatuar; dhe nëntë (9) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për detyrimet kontingjente në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë.	Regjistri i detyrimeve kontingjente ishte i saktë.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se aplikon procedurat e duhura të prokurimit ashtu siç parashihet me kërkesat ligjore, duke siguruar se procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të përdoret në rrethana të arsyeshme sipas LPP.	Edhe në vitin 2022, kemi hasur kur prokurimi nuk kishte zbatuar procedurën e duhur të prokurimit	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave publike kornizë me çmim për njësi në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.	Nuk ka filluar zbatimin i këtij rekomandimi. tejkalim të kontratave kemi te kategoria mallra dhe shërbime	Nuk ka filluar zbatimin



4.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës.	Edhe në vitin 2022 komuna kishte punësuar punëtor me kontrata për shërbime të veçanta pa respektuar procedurat e prokurimit.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e nënshkrimit të kontratave publike kornizë fillimisht të bëjë një analizë të mirëfilltë të nevojave reale, në mënyrë që gjatë ekzekutimit mos të kryhen shërbime apo pozicione që nuk kanë qenë të përfshira në specifikacionin e kontraktuar.	Nga testimi i mostrave tona nuk ka rezultuar ndonjë çështje e kësaj natyre.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve do të respektohen kërkesat e dala nga rregullorja, ashtu që për mbështetja financiare për OJQ-të të bëhet me thirrje publike.	Nuk kemi hasur ndonjë çështje të kësaj natyre.	I zbatuar
7.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Rekomandim i pazbatuar sepse prap kemi keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Komuna nuk kishte arrit që ta bëjë verifikimin e të gjitha pronave komunale.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.	Kjo dukuri ka vazhduar edhe në vitin 2022, me ç'rast urdhërblerja është lëshuar pas faturës dhe raportit të pranimit, rastet janë rritur te kategoria mallra dhe shërbime.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale përmes kontratave kornizë, nevojat të vlerësohen saktë dhe të sigurojë se menaxherët e kontratës ushtrojnë kontrolle të rregullta për furnizime të çdo artikulli sipas kontratës kornizë dhe nuk bëjnë tejkalim të sasive të kontraktuara.	Nuk kemi vërejt tejkalime të pozicioneve.	I zbatuar

11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.	Për mostrat e testuar kemi vërejtur se fondet ishin siguruar sipas kërkesave ligjore.	I zbatuar
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Pasurit mbi 1,000€ edhe në 2022 nuk janë të sakta.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Edhe vitin 2021, është raportuar se ka rritje të llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak dhe si rezultat ky rekomandim mbetet i pa zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë shlyerjen e obligimeve të papaguara për shpronësim. Para së të vendos për shpronësimin e tokave të bëjë një analizë të mirëfilltë për të siguruar se do të ketë mjete të mjaftueshme buxhetore për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet e parapara të shpronësimit.	Edhe këtë vit ka vonesa në kryerjen e obligimeve.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

---

ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

---

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjiçanit, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Alban Hyseni



Data: 11.Maj. 2023, Gjiçan,

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.